E kam pyetur Profetin ﷺ: "Cili është gjynahu më i madh tek Allahu?" Më tha: “T'i bësh ortak Allahut, ndërsa Ai të ka krijuar

Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: "E kam pyetur Profetin ﷺ: "Cili është gjynahu më i madh tek Allahu?" Më tha: “T'i bësh ortak Allahut, ndërsa Ai të ka krijuar.” Thashë: "Kjo me të vërtetë që është e madhe. E, pastaj cili?" Më tha: “Të vrasësh fëmijën tënd nga frika se do të ushqehet së bashku me ty.” E pyeta prapë: "Pastaj cili?" Më tha: “Të bësh kurvëri me gruan e fqinjit.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ është pyetur për gjynahun më të madh, e në atë rast ka thënë: Gjynahu më i madh është shirku i madh, që nënkupton: t'i bësh Allahut të ngjashëm ose të barabartë në uluhijen (adhurimin), rububijen (zotërimin) ose emrat dhe cilësitë e Tij. Këtë mëkat Allahu i Lartësuar e fal vetëm me pendim dhe nëse kryerësi i tij vdes në këtë gjendje, do të mbetet përgjithmonë në Zjarr. Pastaj vrasja që njeriu ia bën fëmijës së tij nga frika se do të hajë me të, pastaj vrasja e njeriut që është e ndaluar (të vritet), por mëkati i tij zmadhohet nëse i vrari është i afërm me vrasësin, gjithashtu mëkati i tij zmadhohet edhe kur qëllimi i vrasësit është frika se personi i vrarë do të marrë pjesë me të në rrizkun e Allahut. Pastaj, që një njeri të bëjë kurvëri me gruan e fqinjit të tij duke u përpjekur të mashtrojë gruan e fqinjit të tij, në mënyrë që të bëjë kurvëri me të dhe ajo t'i nënshtrohet atij. Kurvëria është e ndaluar, por mëkati i saj rritet nëse ajo me të cilën është kryer ky akt është gruaja e fqinjit, ndaj të cilit feja urdhëron bamirësi, mirësi dhe shoqërim të mirë.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5359